

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXV, nr. 8170
E martë, 28 tetor 2025
Çmimi 0.50 €

Diaspora nis votimin
për rundin e dytë
të zgjedhjeve lokale
në Kosovë | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

POLITIKA E BE-së NDAJ KOSOVËS NË 'AUTOPILOT'

Masat e BE-së ndaj Kosovës vazhdojnë, ndërkaq pasojat ekonomike janë të mëdha. Projektet e pezulluara për shkak të masave nga BE-ja i kanë kushtuar Kosovës miliona euro. Analistët paralajmërojnë se mungesa e vëmendjes evropiane ndaj Ballkanit Perëndimor, mund të sjellë rreziqe të reja për paqen dhe stabilitetin

AKTUALE



**TRUMP: PUTIN DUHET TË NDALE
LUFTËN NË UKRAINË E JO TË
TESTOJË RAKETA** F.2

**KUSARI-LILA SHPRESON ENDE:
KANË MBETUR EDHE NËNTË DITË,
MUND TË FORMOHET QEVERIA
KURTI 3** F.3

**OSMANI PËR VIZITË PUNE NË
RIAD, PRITET ME NDERIME
USHTARAKE** F.3

EKONOMI



**KËSHILLI I INVESTITORËVE
EVROPIANË: VONESAT NË SEPA I
KANË KUSHTUAR KOSOVËS 29
MILIONË EURO NË GJASHTË MUJ** F.8

**LIBURN ALIU EMËROHET DREJTOR I
PORTIT TË DURRËSIT** F.8

SPORT



**DAKU: FITORJA NDAJ SERBIË
MË E MADHJA NË KARRIERË,
FANTASTIKE QË SHQIPËRIA DHE
KOSOVA TË JENË NË BOTËTOR** F.11



**KAMBERI KËRKON PËRKRAHJEN E SHBA-së
PËR TË DREJTAT E BARABARTA TË
SHQIPTARËVE NË LUGINË TË PRESHEVËS** F.3

**KOKËFORTËSIA E KURTIT
DHE PASIVITETI I OPOZITËS
PO E MBAJNË KOSOVËN NË
NJË BLLOKADË TË GJATË
INSTITUCIONALE!?** F.6



Shkruan: Ismet KRYEZIU,
drejtor i KDI-së

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

TRUMP: PUTIN DUHET TË NDALË LUFTËN NË UKRAINË E JO TË TESTOJË RAKETA

UASHINGTON, 27 TETOR - Presidenti amerikan, Donld Trump, tha se homologu i tij rus, Vladimir Putin, duhet t'i japë fund luftës në Ukrainë në vend se të testojë raketa me kapacitet bërthamor. Udhëheqësi amerikan shtoi se vendi i tij e ka të pozicionuar një nëndetëse bërthamore afër brigjeve të Rusisë. Një ditë më parë, Putin tha se Rusia ka testuar me sukses raketën lundruese, që funksionon me energji bërthamore, Burevestnik - armë me kapacitet bërthamor që Moska pretendon se mund të depërtojë në çdo mburojë mbrojtëse. Putin tha se shteti do të lëvizë drejt dislokimit të kësaj arme. Moska tha se raketa 9M730 Burevestnik (e njohur si Storm Petrel) kishte fluturuar 14.000 kilometra. I pyetur në bordin e avionit presidencial për testimin e raketës, që NATO e ka quajtur SSC-X-9 Skyfall, Trump tha se ShBA-ja nuk ka nevojë të fluturojë aq larg, pasi ka një nëndetëse bërthamore në

brigjet e Rusisë. “Ata e dinë që ne kemi një nëndetëse bërthamore, më të mirën në botë, pranë brigjeve të tyre. Kështu që, nuk kemi nevojë të fluturojmë 8 mijë milje [14.000 kilometra]”, u tha Trump gazetarëve sipas një audio-incizimi të publikuar nga Shtëpia e Bardhë. “Dhe, për hir të së vërtetës, nuk mendoj se është gjëja e duhur që Putini të flasë për këtë. Ai duhet t'i japë fund luftës, luftë që duhej të zgjaste vetëm një javë... e që tani është në vitin e katërt të saj, e jo të testojë raketa”. Që kur u bë publik raketa 9M730 Burevestnik më 2018, Putin e ka paraqitur këtë armë si përgjigje ndaj lëvizjeve të ShBA-së për të krijuar një mburojë nga sulmet ajrore, pasi Uashingtoni më 2001 u tërhoq nga Traktati për raketa antibalistike i vitit 1972. I pyetur për deklaratat e Trumpit, Kremli tha se Rusia udhëhiqet nga interesat e saj kombëtare, por nuk sheh arsye që testimi i raketës të përkeqësojë raportet me



Shtëpinë e Bardhë. “Pavarësisht gatishmërisë sonë për dialog me Shtetet e Bashkuara, Rusia - para së gjithash presidenti i saj-udhëhiqet nga interesat kombëtare”, tha zëdhënësi i Kremilit, Dmitry Peskov. Trump vazhdimisht ka folur për dislokimin e nëndetëseve

amerikane pranë brigjeve të Rusisë, pas deklaratave të ish-presidentit rus, Dmitry Medvedev, mbi rrezikun e një lufte midis dy fuqive bërthamore. Megjithatë, është gjë e rrallë që palët të flasin publikisht për vendndodhjen e nëndetëseve të

armatosura me armë bërthamore. Duke folur për testimin e raketës ruse, Trump u shpreh: “Ne testojmë raketa gjatë gjithë kohës”. “Ata nuk po luajnë lojëra me ne, e as ne nuk po luajmë lojëra me ta”, tha Trump.

MALI I ZI VENDOS VIZAT PËR TURQIT, PAS NJË SËRË ARRESTIMESH NË PODGORICË

PODGORICË, 27 TETOR - Qeveria e Malit të Zi do të heqë të hënën - me procedurë të përshpejtuar - regjimin pa viza për shtetasit turq, njoftoi kryeministri Millojko Spajiq në orët e vona të së dielës përmes një postimi në X. “Do të nisim bisedime intensive me Turqinë për të gjetur, në frymën e bashkëpunimit të mirë dhe aleancës, modelin më të mirë në interes të të dyja palëve”, tha Spajiq. Ai nuk dha arsye për heqjen e regjimit pa viza. Njoftimi i Spajiqit erdhi pasi policia gjatë një aksioni në lagjen Zabello të Podgoricës arrestoi rreth 50 shtetas të Turqisë, përfshirë dy persona për të cilët dyshohet se morën pjesë në një përlëshje ku një banor i Podgoricës, M.J., u



plagos me thikë, njoftoi Policia malazeze pas orës 22:00 të dielën. Përlëshja ndodhi natën mes së shtunës dhe së dielës në një kafene në Zabello. Gjatë arrestimeve, u mbledh një

grup i madh qytetarësh që brohoritnin mesazhe me gjuhë të urrejtjes, përkatësisht duke nxitur dhunë ndaj turqve. Policia ndaloi disa nga të pranishmit që të afroreshin pranë objekteve ku ndodheshin shtetasit turq.

Qytetarëve iu drejtua edhe ministri i Punëve të Brendshme, Danilo Sharanoviq, i cili tha se është manipulim të thuhet se në Mal të Zi qëndrojnë 100.000 shtetas turq dhe shpjegoi se numri i tyre është 13.000, prej të cilëve 80 kanë qëndrim të përhershëm. Mbrëmjen e së dielës, një numër i madh i automjeteve policore u vendosën para ndërtesës së Ambasadës turke në Podgoricë. Deputeti Boris Bogdanoviq nga Partia Demokratike në pushtet, subjekti i ministrit Sharanoviq, publikoi një fotografi të arrestimeve me mbishkrimin: “Mbrojmë vendin tonë. Mbrojmë çdo shtëpi”. Policia lidhi arrestimet me, siç tha, incidente me elemente dhune gjatë 24 orëve të fundit, në të cilat morën pjesë shtetas

turq që qëndrojnë përkohësisht në Podgoricë. Nga policia thanë se do të verifikojnë ligjshmërinë e qëndrimit të tyre dhe nëse gjatë qëndrimit ka pasur dhunë, mund të ketë veprime për anulimin e qëndrimit ose dëbim nga vendi. Nga rreth 100.000 të huaj në Mal të Zi, 13.400 janë shtetas turq, sipas të dhënave zyrtare të policisë. Më shumë janë shtetas serbë dhe rusë, gjithsej rreth 50.000. Ndryshe, Turqia është një ndër vendet për të cilat Mali i Zi ka hequr vizat, gjë për të cilën Komisioni Evropian ka kërkuar nga Podgorica që të harmonizojë politikën e vizave me Bashkimin Evropian. Shtetasve turq u kërkohet vizë për të hyrë në vendet e BE-së.

Turqia e akuzon kryetarin e burgosur të Stambollit për “spiunazh politik”

STAMBOLL, 27 TETOR - Një gjykatë turke ka lëshuar një tjetër fletarrestim zyrtar për kryetarin e burgosur të Stambollit, Ekrem Imamoglu, nën dyshimet për “spiunazh politik”, raportoi media shtetërore Anadolu më 27 tetor. Imamoglu, një rival kyç i presidentit turk, Recep Tayyip

Erdogan, që gjendet në burg që nga marsi dhe po pret gjykimin për akuzat për korrupsion, në korrik u dënua për një tjetër vepër, atë të fyerjes dhe kërcënimit ndaj prokurorit kryesor të Stambollit. Ai mohon të gjitha akuzat ndaj tij. Imamoglu e mohoi akuzën e fundit ndaj tij gjatë paraqitjes

në gjykatë të dielën dhe përmes një deklarate të lëshuar nga burgu. “Një shpifje, gënjeshtër dhe komplot i tillë nuk do t'i kalonte nëpër mendje as djallit”, u tha në deklaratën e tij të publikuar në X. “Po përballemi me një turp që nuk mund të përshkruhet me fjalë”.



DIASPORA NIS VOTIMIN PËR RUNDIN E DYTË TË ZGJEDHJEVE LOKALE NË KOSOVË

PRISHTINË, 27 TETOR - Nga 27 tetori deri më 8 nëntor, qytetarët e Kosovës që jetojnë jashtë vendit mund të votojnë përmes postës për raundin e dytë të zgjedhjeve për kryetarë të komunave. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) njoftoi se të drejtë vote kanë vetëm 29.712 shtetas të Kosovës që ishin regjistruar me sukses për votim jashtë vendit për rundin e parë të zgjedhjeve lokale të mbajtura më 12 tetor. “KQZ-ja ka nisur procesin e votimit jashtë vendit para certifikimit të rezultateve për të shmangur vonesat në procesin zgjedhor dhe për të siguruar që çdo qytetar i regjistruar të ketë mundësinë të ushtrojë të drejtën e tij kushtetuese për të votuar në kohë”, u tha në njoftim. Më 25 tetor, KQZ-ja shpalli rezultatet përfundimtare për zgjedhjen e kryetarëve në 35 komuna, ndërkah rezultatet ende nuk janë shpallur për Prishtinën, Junikun dhe Mamushën, pasi në këto komuna ka afat ligjor prej 48-

orësh për parashtrimin e ankesave në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia. KQZ-ja u dërgon qytetarëve të diasporës përmes postës pakon me fletëvotim për kryetarin e komunës. Më pas, votuesi është i detyruar që atë pako me fletëvotim ta dërgojë në ndonjërin prej kutive postare të KQZ-së në 22 vende të botës dhe në Kosovë. Raundi i balotazhit do të zhvillohet më 9 nëntor në 18 komuna dhe KQZ-ja veçse ka certifikuar listën e votuesve për votimet. Komunitet ku do të ketë balotazh janë Gjakova, Gjilani, Dragashi, Kaçaniku, Klina, Fushë Kosova, Mitrovica e Jugut, Obiliqi, Rahoveci, Peja, Prishtina, Prizreni, Suhareka, Vitia, Vushtrria, Juniku, Mamusha dhe Klokoti. Sipas vendimit të KQZ-së, për këtë rund zgjedhjesh do të shtypen 1.158.015 fletëvotime - rreth 16 për qind më pak se numri i përgjithshëm i qytetarëve me të drejtë vote në këtë raund. Për zgjedhjet e rundit të parë,



të zhvilluara më 12 tetor, KQZ-ja kishte certifikuar listën me mbi dy milionë persona të drejtë vote, prej të cilëve 43.993 ishin votues të

regjistruar nga jashtë Kosovës. Megjithatë, në 20 komuna, kryetarët e rinj dhe përbërja e re në asamble komunale u zgjodhën qysh në raundin e

parë të zgjedhjeve lokale. Në raundin e parë, në Kosovë votuan 39.58 për qind e mbi 2 milionë qytetarëve me të drejtë vote brenda vendit.

KUSARI-LILA SHPRESON ENDE: KANË MBETUR EDHE NËNTË DITË, MUND TË FORMOHET QEVERIA KURTI 3

PRISHTINË, 27 TETOR - Kryetarja e Alternativës, Mimoza Kusari-Lila, ka deklaruar se gjatë ditëve të mbetura të afatit kushtetues ekziston mundësia që disa deputetë të ndryshojnë qëndrim dhe të mundësojnë formimin e Qeverisë Kurti 3, duke theksuar se disa deputetë nuk mund të jenë më në Kuvend. Kusari-Lila në një intervistë për “Ekonomia Online”, ka vlerësuar se në mungesë të reflektimit politik, Kosova po shkon drejt zgjedhjeve të reja parlamentare. “Unë besoj që i vetmi ndryshim mund të jetë që në rast se ka vullnet të deputetëve të caktuar për të votuar qeverinë dhe mandatarin, në këtë rast kryeministri Albin Kurti mund të garantojë se i ka 61 vota dhe të thirret një seancë tjetër brenda afatit kushtetues. Kjo është e vetmja formë, por jam e bindur se nëse nuk ka ndryshim të qasjes apo të pozicioneve, zgjedhjet, siç po shihet, po shkojnë drejt atij drejtimi”, ka thënë Kusari-Lila.



Sipas saj, edhe pse nuk ka shumë shpresë, deputetët kanë ende hapësirë për reflektim. “Unë besoj që brenda këtij 24-orëshi deputetët e kanë pasur mundësinë, nëse do ta kenë edhe në ditët dhe orët në vijim hapësirën për të reflektuar. Procesi zgjedhor është proces

zgjedhor dhe ne natyrisht përgatitemi, edhe prej më herët e kemi ditur se zgjedhjet, siç e kam deklaruar publikisht, janë e vetmja zgjidhje e qëndrueshme duke marrë parasysh edhe proceset tjera, zgjedhjen e presidentit. E vetmja mënyrë për një qeveri që të ketë një afat më

të shkurtër ka qenë votimi ose pranimi i Qeverisë Kurti të propozuar dje në mënyrë që të tejkalohet kjo bllokadë me çështjen e buxhetit dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, ka theksuar ajo. Kusari-Lila ka theksuar se disa deputetë duhet ta kuptojnë se

mund të jetë hera e fundit që janë pjesë e Kuvendit. “Unë në veçanti nuk kam shpresë, por nëse ata kanë reflektime, le ta vlerësojnë vetë. Ka deputetë, fatkeqësisht, siç ju kam thënë edhe në seancë disave që e kanë parë për këtë periudhë të shkurtër Kuvendin ose kanë qenë e kanë marrë këtë mandat dhe do të jetë mandati më i shkurtër ndonjëherë në Kosovë për deputetë që janë zgjedhur disa për herë të parë, ndoshta edhe të fundit. Disa nuk e di a do të kenë mundësinë që të zgjidhen prapë. Ka qenë një mundësi për të tejkaluar një ngërç të krijuar si rrjedhojë me pasojë të tjera për qytetarët dhe ndoshta me reflektim dhe konstruktivitet për deputetët. A do të ketë diçka të tillë nuk e di, por mundësia ekziston edhe 9 ditë të mbetura për këdo që mund t'i ketë 61 numra për Kurtin dhe VV-në”, ka thënë ajo. Lidhur me hapat e mëtejshëm, Kusari-Lila ka thënë se gjithçka mbetet në dorën e presidentes.

Osmani për vizitë pune në Riad, pritët me nderime ushtarake

PRISHTINË, 27 TETOR - Presidentja Vjosa Osmani ka arritur në Riad të Arabisë Saudite, me ftesë të Princit të Kurorës së Arabisë Saudite, Muhamed bin

Salman, për të marrë pjesë në Future Investment Initiative (FII). Ky forum, i njohur si një nga ngjarjet më prestigjioze globale

për investime dhe inovacion, mbledh udhëheqës botërorë, drejtues të korporatave më të mëdha ndërkombëtare, investitorë, dhe ekspertë të

teknologjisë e politikave publike, për të diskutuar idetë dhe strategjitë që do të formësojnë ekonominë dhe shoqëritë e së ardhmes.





POLITIKA E BE-së NDAJ KOSOVËS NË “AUTOPILOT”

Masat e BE-së ndaj Kosovës vazhdojnë, ndërkaq pasojat ekonomike janë të mëdha. Projektet e pezulluara për shkak të masave nga BE-ja i kanë kushtuar Kosovës miliona euro. Analistët paralajmërojnë se mungesa e vëmendjes evropiane ndaj Ballkanit Perëndimor, mund të sjellë rreziqe të reja për paqen dhe stabilitetin

PRISHTINË, 27 TETOR - Masat e BE-së ndaj Kosovës vazhdojnë, edhe pse komuniteti serb është rikthyer në jetën politike dhe rrethanat që i kanë justifikuar, kanë ndryshuar. Pasojat ekonomike janë të mëdha - projektet e pezulluara për shkak të masave i kanë kushtuar Kosovës miliona euro. Analistët paralajmërojnë se mungesa e vëmendjes evropiane ndaj Ballkanit Perëndimor, mund të sjellë rreziqe të reja për paqen dhe stabilitetin. Masat ndëshkuese të Bashkimit Evropian kundër Kosovës janë bërë sinonim i një dënimi të zgjatur - sipas disave pa arsye. Ndryshe nga koha kur janë vendosur, komuniteti serb ka marrë pjesë në zgjedhjet e sivjetme parlamentare dhe lokale në Kosovë, duke ndryshuar ndjeshëm kushtet që dikur i kanë justifikuar. “Besojmë se tani nuk ka asnjë kusht që i arsyeton masat kundër Kosovës. Me mbajtjen e zgjedhjeve, serbët kanë përfaqësuesit e tyre politikë në

nivel lokal dhe qendror. Kjo, në njëfarë forme, shënon rikthimin e jetës politike normale të komunitetit serb në Kosovë”, thotë Besar Gërgi, nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike, për programin “Expose” të “Radios Evropa e Lirë”. Ky grup është një nga 12 organizatat e shoqërisë civile që i kërkuar javën e kaluar BE-së heqjen e masave ndaj Kosovës, duke argumentuar se rrethanat fillestare nuk vlejné më dhe se masat po dëmtojnë procesin e integritetit evropian. “Radio Evropa e Lirë” pyeti në BE nëse është duke u diskutuar heqja e tyre, por nuk mori përgjigje. Mediat cituan vetëm konfirmimin e një zëdhënëseje se BE-ja ka pranuar letrën nga shoqëria civile në Kosovë. Këto masa, që përfshijnë ngrirjen e një pjese të fondeve të BE-së dhe pezullimin e takimeve të nivelit të lartë me zyrtarët kosovarë, u vendosën në mesin e vitit 2023, pas përshkallëzimit të tensioneve

në veriun e vendit të banuar me shumicë serbe dhe disa veprimeve të Qeverisë, të cilat BE-ja i përshkroi si të pakoordinuara dhe në dëm të komunitetit serb. Disa shenja të zbutjes, megjithatë, nisën të shihen së voni, përfshirë edhe nga takimet e ndara që presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, zhvilloi më 15 tetor në Prishtinë me presidenten Vjosa Osmani dhe kryeministrin në detyrë, Albin Kurti. Në komunikatën që lëshoi në X, von der Leyen tha vetëm se është e rëndësishme që Kosova të vazhdojë të ndërtojë institucione të forta, t’i ulë tensionet dhe t’i finalizojë hapat e nevojshëm për të përfutur nga Plani i Rritjes i BE-së. Në shkurt të këtij viti, “Radio Evropa e Lirë” raportoi se një projekt i Ngrrohtores së Qytetit të Prishtinës, “Termokos”, për dyfishimin e kapaciteteve të ngrohjes në kryeqytet, ishte pezulluar, për shkak të ngrirjes së një granti prej mbi 17 milionë eurosh nga Bashkimi Evropian. Lagjet që do të përfitonin nga ky projekt, përfshijnë: Prishtinën e Re, Kalabrinë, Matin I dhe Rugën C. Tetë muaj pas atij raportimi, “Termokos”-i konfirmon se gjendja mbetet e njëjtë. “Projekti nuk ka filluar me fazën e zbatimit, për shkak se

granti nga Bashkimi Evropian është pezulluar përkohësisht, si rezultat i masave të BE-së ndaj Kosovës. Për rrjedhojë, procesi i përparimit të projektit mbetet në pritje derisa këto masa të hiqen”, thuhet në përgjigjen e ndërmarrjes dërguar “Radios Evropa e Lirë”. Si ky rast, ka edhe të tjerë. Një raport i publikuar në maj nga Instituti për Studime të Avancuara GAP në Prishtinë nxori në pah se masat ndëshkuese të BE-së i kanë kushtuar Kosovës rreth 613.4 milionë euro për projekte të pezulluara ose të shtyra për një afat të pacaktuar. Nga kjo shumë, 7.1 milionë euro janë humbur tërësisht, ndërsa sektorët më të prekur janë: mjedisi, energjia, digjitalizimi dhe kultura. Toby Vogel, analist nga Këshilli i Politikave të Demokratizimit, me seli në Bruksel, thotë se Bashkimi Evropian ka muaj që është i zënë me kriza madhore në botë - nga Ukraina në Lindjen e Mesme - dhe politikën ndaj Kosovës e ka lënë në “autopilot”. “Mendoj se ky është një nga ata shembujt e politikave të BE-së që funksionojnë thjesht në mënyrë automatike. Aktualisht, BE-ja nuk ka udhëheqje të qartë sa i përket çështjes së Kosovës ose të Serbisë, të cilat lidhen me njëra-tjetrën përmes dialogut. Askush - as lider kombëtar, as zyrtar, as komisionar - nuk dëshiron të

investojë kapital politik në një çështje që shihet si relativisht e parëndësishme”, thotë Vogel për “Exposenë”. Për të, këto masa kanë qenë të padrejta ndaj Kosovës që nga fillimi, sidomos duke pasur parasysh se Serbia nuk është përballur me diçka të ngjashme, pavarësisht dyshimeve për përfshirjen e saj në sulmin e armatosur në Banjskë në vitin 2023. Vogel nuk e përjashton mundësinë që BE-ja të vazhdojë t’i përdorë masat si mjet presioni edhe për çështje të tjera politike në Kosovë. Por, pavarësisht kësaj, ato nuk duket se kanë ndikuar në orientimin properëndimor të qytetarëve të Kosovës. Një anketë e zhvilluar nga Instituti Ndërkombëtar Republikan në periudhën maj-korrik të këtij viti nxori në pah se 85 për qind e qytetarëve të anketuar në Kosovë mbështesin një politikë të jashtme pro-BE dhe properëndimore, krahasuar me vetëm 9 për qind në Serbi. Gërgi thotë se një pjesë të përgjegjësisë për vazhdimin e masave të BE-së e mbajnë edhe institucionet vendore, të cilat prej muajsh kanë qenë jofunksionale ose në detyrë. “Ne, si shoqëri civile, mund ta hedhim hapin e parë, mund ta bëjmë atë që është në kuadër të veprimtarisë sonë, porse, padyshim, pesha kryesore në këtë aspekt u ngarkohet institucioneve shtetërore. E,

KOKËFORTËSIA E KURTIT DHE PASIVITETI I OPOZITËS PO E MBAJNË KOSOVËN NË NJË BLOKADË TË GJATË INSTITUCIONALE!?



Shkruan: Ismet KRYEZIU, drejtor i KDI-së

Zgjedhjet duken tashmë të pashmangshme. Por pyetja e vërtetë është: a do të jenë ato zgjidhje apo vetëm vazhdim i krizës politike?

Sot kemi një konfirmim të mungesës së vullnetit politik të Albin Kurtit për të bashkëqeverisur apo ndarë përgjegjësinë me opozitën. Në anën tjetër, kemi edhe një refuzim të qartë të bashkëpunimit me Kurtin nga ana e opozitës. Kjo ka krijuar një rreth të mbyllur, ku asnjëra palë nuk është e gatshme të ndryshojë pozicionin e vet, dhe vendi ka mbetur pa funksionalitet institucional.

Për më tepër, kokëfortësia e Kurtit për të qeverisur i vetëm, e përforcuar nga bindja se ai është i vetmi garant i “vullnetit qytetar”, ka krijuar një klimë politike të mbyllur dhe përjashtuese. Ai nuk e shih

bashkëpunimin si domosdoshmëri institucionale, por si rrezik për kontrollin e tij mbi pushtetin. Edhe kur qeveris me parti të tjera, ato duhet të jenë në pozita nënshtrimi dhe jo partneriteti. Kjo e bën sistemin politik të brishtë, dhe me shumë gjasë, as zgjedhjet e reja nuk do ta ndryshojnë këtë qasje. Përkundrazi, një fitore tjetër e Kurtit do ta forconte ndjesinë e tij të vetë-mjaftueshmërisë politike dhe do t'i forconte më tej kulturën e përjashtimit.

Pra çfarë ndodh nëse pas zgjedhjeve kemi të njëjtat rezultate, ose renditje të njëjtë të subjekteve politike? A do të kemi një zgjidhje reale, apo një krizë të përsëritur, me aktorë të lodhur dhe institucione të bllokuara? Nëse nuk mund të përballojmë një tjetër krizë politike, atëherë ndryshimi i pozicioneve politike bëhet i

pashmangshëm. Por lind pyetja tjetër: A ia ka vlejtur që Kosova të mbetet për më shumë se një vit pa institucione funksionale, nën sanksione ndërkombëtare dhe pa përgjegjësi institucionale e politike, vetëm që partitë të ripërcaktojnë pozicionet e tyre? Në anën tjetër, zgjedhjet shpesh përmenden si mundësi që gjenerojnë opsionin e ndryshimit të pushtetit dhe krijimin e një qeverie alternative pa Kurtin. Por kjo ide, sado joshëse për ata që duan “ndryshim”, mbetet e paqartë në përmbajtje. Sepse as partitë opozitare nuk kanë arritur për një vit të gjejnë gjuhë të përbashkët për të ndërtuar një ofertë qeverisëse. Dhe me shumë gjasë, as pas zgjedhjeve nuk do ta kenë të lehtë ta bëjnë këtë.

Një opozitë pa energji, pa guxim dhe pa vizion vështirë se mund

të krijojë një opsion politik alternativ përballë Kurtit. Liderët e saj, edhe pse më të rinj dhe me përpjekje për reforma të brendshme, vazhdojnë të jenë të lodhur nga e kaluara, pa reflektim dhe pa ofertë të re. Deri më sot, veprimet e tyre politike kanë qenë kryesisht reagime, ndërsa përveç refuzimit të Kurtit, nuk mbahen mend për ndonjë veprim që ka sjellë shpresë apo frymëzim për ndryshim. Kanë artikuluar ndonjëherë kritika për tema periferike, por asnjëherë një vizion që frymëzon.

Me këtë qasje të opozitës, Kurti po e luan i vetëm edhe rolin e pushtetit, edhe të opozitës. Përveç mungesës së institucioneve funksionale, kjo është kriza më e madhe politike e vendit: mungesa e një zëri që sfidon realisht pushtetin. Opozita s'mund të fitojë duke

pritur që Kurtin ta rrëzojnë vetë qytetarët, ndërkombëtarët apo lodhja e pushtetit. Duhet të guxojnë të marrin përgjegjësi, të kenë ide, njerëz të rinj dhe veprime politike të qarta. Pa këto parakushte, vështirë të ketë alternativë opozitare.

Prandaj, ndryshimi i vërtetë nuk qëndron tek cikli i zgjedhjeve. Çdo proces zgjedhor mund të prodhojë vetëm rotacion partish, por pa një kulturë të bashkëpunimit, konsensusit politik dhe përparësisë së interesave shtetërore mbi ato personale, Kosova do të vazhdojë të përjetojë krizë politike dhe institucionale. Vetëm përmes veprimeve politike të përgjegjshme, të guximshme, të orientuara nga ideja e shtetit dhe jo nga interesa të ngushta partiake, vendi mund të ecë përpara dhe të shmangë bllokimin e mëtejshëm.

nëse ato janë me mandat të kufizuar, kjo domosdo ka efekt në politikën e jashtme”, thotë Gërgi.

Pas takimit me von der Leyenin në Prishtinë, presidentja Osmani shkroi në “Facebook” se kishte diskutuar edhe për nevojën e heqjes së masave ndaj Kosovës, por nuk zbuloi detaje të tjera.

Vogel thotë se një moment i përshtatshëm për heqjen e masave të BE-së mund të vijë nëse Kosova formon një qeveri të qëndrueshme dhe legjitime, dhe shmang veprimet që BE-ja dhe partnerët e saj i konsiderojnë provokuese ose të njëanshme. “Kosova, sigurisht, po kalon një periudhë të vështirë në aspektin e brendshëm, për shkak të pamundësisë për të formuar

qeverinë dhe gjithë situatës që lidhet me të. Mendoj se, aktualisht, qëndrimi në Bruksel është ‘të presë dhe të shohë’. Ekziston një ndjenjë e përgjithshme se ‘na duhet një lloj zgjidhjeje për ngërçin politik në Prishtinë përpara se të merret ndonjë vendim i rëndësishëm”, thotë Vogel.

Por ai, gjithashtu, paralajmëron se mungesa e vëmendjes nga BE-ja është e rrezikshme, pasi rrit mundësinë e paqëndrueshmërisë dhe dhunës në Ballkanin Perëndimor. Pa një përqendrim politik të BE-së, rajoni mund të përballlet me sfida serioze të sigurisë, sipas tij. “Mendoj se BE-ja ka pasur fat që nuk ka pasur më shumë dhunë, apo dhunë më serioze në Kosovë. Po ashtu, ka qenë me fat që,

deri më tani, nuk ka pasur incidente të dhunshme në Bosnje dhe Hercegovinë. Ajo ka mision të vendosura në të dyja vendet. Në letër i ka mjetet për t'u përgjigjur ndaj çdo sfide të sigurisë, por politikisht i mungon vëmendja dhe gatishmëria. Kjo është një situatë e rrezikshme, sepse ajo që po ndodh në lindje të BE-së, në Ukrainë, ka ndikim zinxhiror edhe në Ballkanin Perëndimor”, thotë Vogel.

Më herët këtë vit, Parlamenti Evropian kërkoi heqjen e masave ndëshkuese kundër Kosovës. Ministrat e Jashtëm të BE-së i sugjeruan gjithashtu Komisionit Evropian heqjen graduale të masave. Por, në një intervistë dhënë “Radios Evropa e Lirë” në prill, komsionarja për Zgjerim e BE-

së, Marta Kos, tha se jo të gjitha shtetet e BE-së janë dakord për heqjen e masave ndaj Kosovës. Për një vendim të tillë kërkohet konsensusi i të 27 shteteve anëtare, e mes tyre janë edhe pesë vende që ende nuk e njohin pavarësinë e Kosovës - Spanja, Greqia, Rumania, Sllovakia dhe Qiproja.

Megjithatë, edhe përpara vendosjes së masave, nuk është vërejtur ndonjë gatishmëri reale për ta avancuar Kosovën në procesin e integritet evropian. Ajo mbetet i vetmi vend në Ballkanin Perëndimor pa status kandidati për anëtarësim në BE. Aplikimin për t'u bërë pjesë e bllokut e ka dorëzuar në fund të vitit 2022, por, pothuajse tre vjet më vonë, kërkesa ende nuk është

marrë në shqyrtim.

Për shkak të vonesës në formimin e institucioneve qendrore, Kosova mbetet edhe jashtë Planit të Rritjes së BE-së dhe nuk mund të përfitojë nga fondet e parapara. Kjo, sepse marrëveshja ndërkombëtare që mundëson qasjen në ato mjete duhet të miratohet paraprakisht nga Kuvendi.

Gërgi thekson rëndësinë e funksionalizimit të institucioneve sa më shpejt që të jetë e mundur, në mënyrë që ato të nisin një fushatë të koordinuar lobimi në qendrat evropiane.

Por topi, edhe atëherë, do të mbetet në anën e tyre, për të vendosur nëse do ta shpërblejnë Kosovën për përpjekjet e saj, apo thjesht do ta mbajnë në pritje.

Punëtori për hartimin e projektit UA për jetesë të pavarur të mbikëqyrur dhe për aftësim për jetë dhe punë të pavarur

PRISHTINË, 27 TETOR - Grupi i Punës për hartimin e akteve nënligjore, që derivojnë nga Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare, të hënën ka vazhduar me punëtorinë e radhës, ku po hartohet draft-Udhëzimi Administrativ për jetesën e pavarur me mbikëqyrje dhe për aftësimin për jetë dhe punë të

pavarur. Me këtë rast, këshilltarja politike e ministrit të Drejtësisë, Vlora Limani-Hajnuni, theksoi se ky akt nënligjor sjell një politikë të re, e cila nuk ka ekzistuar në legjislacionin e kaluar, por që është e domosdoshme për mbështetjen sociale të grupeve të synuara.

Nga ky shërbim do të përfitojnë të rinjtë dhe të rejtat që kanë qenë pa kujdes prindëror dhe që kanë jetuar në forma alternative të kujdesit deri sa kanë qenë fëmijë, si dhe të moshuarit që kanë mbetur pa përkujdesje familjare. Punëtorja po realizohet me mbështetjen e SOS Fshatrat e Fëmijëve të Kosovës.



KAMBERI KËRKON PËRKRAHJEN E SHBA-së PËR TË DREJTAT E BARABARTA TË SHQIPTARËVE NË LUGINË TË PRESHEVËS

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 27 TETOR - Deputeti shqiptar në parlamentin e Serbisë, Shaip Kamberi, ka takuar në Nju-Jork personalitete të shquara të politikës amerikane dhe të komunitetit shqiptar në ShBA.

Në këtë ngjarje ishin të pranishëm senatori Cory Booker, ish-kongresmeni Joe DioGuardi me bashkëshorten Shirley Cloyes DioGuardi, kandidati për Kongresin amerikan Diamant Hysenaj, si dhe shumë figura të njohura të diasporës sonë si Faton Bislimi, Agim Aliçkaj, Behlul Gashi e të tjerë.

Përmes çështjes së Luginës së Preshevës, Kamberi ka përshkruar realitetin e marrëdhënieve Kosovë-Serbi dhe standardet e dyfishta që ende mbizotërojnë në qasjen e Beogradit ndaj shqiptarëve. “Fola për diskriminimin e vazhdueshëm institucional, pasivizimin e adresave, mohimin e të drejtave themelore dhe për projektin politik të ashtuquajtur ‘Bota serbe’, që paraqet rrezik të drejtpërdrejt për paqen dhe stabilitetin në rajon. Theksova se rasti i shqiptarëve të Luginës së Preshevës është një test i sinjeralitetit demokratik të



Serbisë - nëse ajo është vërtet e gatshme të zbatojë parimet që kërkon t'i përqafojë si vend kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Në të njëjtën kohë, nënvizova se roli i Shteteve të Bashkuara të Amerikës mbetet vendimtar për ruajtjen e paqes dhe mbështetjen e demokracive të reja në Ballkan. Zëri i miqve tanë në Kongres e Senat është dëshmi se çështja jonë e drejtë ka përkrahje dhe mirëkuptim në zemrën e demokracisë amerikane”, ka thënë Kamberi.

Ai ka theksuar se shqiptarët në Luginën e Preshevës prej

dekadash përballen me diskriminim sistematik politik, ekonomik e institucional. “Në vend që të trajtohem si qytetarë të barabartë, për ne vazhdojnë të mungojnë të drejtat themelore në arsim, përdorim të gjuhës, përfaqësim në institucione dhe zhvillim ekonomik. Serbia, e cila paraqitet si candidate për anëtarësim në Bashkimin Evropian, në praktikë e trajton minoritetin shqiptar me standarde të tjera nga ato që kërkon për pakicën serbe në Kosovë. Ajo mohon krimet e luftës dhe glorifikon kriminelët e dënuar në Hagë. Një qasje e

këfillë mohuese jo vetëm që është pengesë e pajtimit mes popujve në Ballkan, por ajo përfaqëson një kundërshtim të vlerave të demokracisë liberale dhe mban gjallë arsyen hegjemoniste serbe”, ka thënë ai, duke shtuar se ky është thelbi i një politike të standardeve të dyfishta. “Beogradi kërkon autonomi politike, garanci kushtetuese e mbrojtje ndërkombëtare për serbët në Kosovë por nuk pranon as të diskutojë për të drejtat elementare të shqiptarëve brenda kufijve të vet. Kjo qasje jo vetëm që dëmton parimin e

barazisë, por ushqen tensione dhe mosbesim ndërmjet komuniteteve”, është shprehur Kamberi.

Ai ka shtuar se më shqetësuese është se kjo politikë është pjesë e një vizioni më të gjerë që quhet “Bota serbe”, një projekt që synon të riprodhojë ndikimin politik e kombëtar të Serbisë mbi popullsitë serbe jashtë kufijve të saj. “Ky projekt, që ka ngjashmëri të rrezikshme me idetë e ‘botës ruse’, përbën kërcënim real për stabilitetin rajonal. Pikërisht për këtë, roli i Shteteve të Bashkuara mbetet thelbësor. Pa angazhimin e qartë dhe të balancuar amerikan, rajoni mund të rrëshqasë në sfera të ndikimit që nuk ndajnë vlerat demokratike perëndimore. Prandaj ne kërkojmë që ShBA të përdorë zërin dhe ndikimin e saj për të nxitur Serbinë të respektojë të drejtat e pakicave jo vetëm në fjalë, por në praktikë, dhe që zgjidhja e çështjeve të hapura në Ballkan të bazohet në parimin e reciprocitetit, të drejtës dhe të barazisë. Zëri juaj, senator Booker, dhe përkrahja e miqve të ShBA-së për të drejtat e barabarta të shqiptarëve në Luginë të Preshevës do të ishte një sinjal i fuqishëm se demokracia dhe drejtësia nuk kanë kufij”, ka deklaruar Kamberi.

Mësim me anë të praktikës: Zhvillohet edicioni i dhjetë i konferencës “Software Freedom Kosova 2025”

PRISHTINË, 27 TETOR - Në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike nga 24 deri më 26 tetor u organizua edicioni i dhjetë i “Software Freedom Kosova 2025”, konferencës kryesore rajonale për softuer dhe harduer të hapur.

Folës kyç i kësaj konference ishte bashkëthemeluesi i kompanisë “Arduino”, David Cuartielles. Kjo kompani është një platformë botërore elektronike me burim të hapur për programe

softuerike dhe harduerike të lehta për t'u përdorur. Pllakat e punuara nga kjo kompani lexojnë, për shembull, dritën në një sensor, gishtin në një buton ose një mesazh në x, dhe varësisht nga urdhrat që marrin, i kthejnë këto veprime në ndezje të një motori, një drite, ose publikojnë diçka në internet.

Në konferencë u paraqitën edhe folës të tjerë vendës e ndërkombëtarë, të cilët ndanë risitë dhe përvojat e tyre në

fushat e teknologjisë.

Gjithashtu, u zhvilluan sesione rreth inteligjencës artificiale dhe mësimi automatik (AI/ML), prezantime dhe punëtori. Një rol të rëndësishëm për mbarrëvajtjen e konferencës, përveç personelit dhe studentëve të FIEK-ut, e patën edhe vullnetarët e “Free Libre Open Source Software Kosova”. Studentë dhe profesorë të FIEK-ut po në tetor morën pjesë në Kampionatin Evropian të Sigurisë Kibernetike (ECSC 2025).



Ndërsa ish-studentja e këtij fakulteti, Dredhza Braina, ishte në listën e ngushtë për çmimin e njohur ndërkombëtar

“Cybersecurity Women of the Year 2025” dhe në gusht 2025 fitoi në kategorinë “Barrier Breaker” të kësaj gare.

Nënshkruhet vendimi, Mali Mokna dhe Liqeni i Ujmanit vihen nën mbrojtje

PRISHTINË, 27 TETOR - Ushtruesi i detyrës së ministrit të Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Hysen Durmishi, ka njoftuar se ka nënshkruar vendimin për mbrojtje paraprake të Malit Mokna dhe Liqenit të Ujmanit, duke theksuar se me këtë vendim, Republika e Kosovës bëhet shteti me përqindjen më të lartë të territorit nën mbrojtje të natyrës në gjithë Ballkanin Perëndimor. “Kemi

vënë nën mbrojtje ‘Malin Mokna dhe Liqenin e Ujmanit’. Të dashur qytetarë, javën e kaluar kam nënshkruar vendimin për mbrojtje paraprake të ‘Malit Mokna dhe Liqenit të Ujmanit’, një nga vendimet më të rëndësishme për mbrojtjen e natyrës në vendin tonë. Me këtë vendim, Republika e Kosovës bëhet shteti me përqindjen më të lartë të territorit nën mbrojtje të natyrës në gjithë Ballkanin

Perëndimor. Pas një studimi njëvjeçar në terren, është konstatuar se kjo zonë përbën pasuri të rrallë natyrore, me biodiversitet të pasur dhe peizazhe me rëndësi të veçantë ekologjike e shkencore. Zona me sipërfaqe prej 192.19 km² tashmë vihet nën mbrojtje paraprake, duke e ngritur në 12.4% përqindjen e territorit të Kosovës që mbrohet ligjërisht”, ka shkruar Durmishi.



RAMA E PADIT MURATIN PËR BLOKADËN E BUXHETIT

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 27 TETOR - Kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, ka njoftuar se ka inicuar një padi ndaj ministrit në detyrë të Financave, Hekuran Murati, për bllokadën e buxhetit.

Rama ka thënë se punëtorët e ndërmarrjes “Gjelbër” prej kohësh po përballen me vonesa në marrjen e pagave të tyre, si pasojë e bllokadës së buxhetit nga Qeveria. “Sot i pritja në takim përfaqësuesit e ndërmarrjes, të cilëve me shqetësim dhe mirëkuptim të thellë njerëzor u shpjegova situatën e krijuar. Kjo bllokadë, e cila po dëmton jo vetëm punëtorët por edhe shërbimet publike jetike të kryeqytetit, është e pajustificueshme, e paligjshme dhe me prapavijë të qartë politike. Për këtë arsye, kemi inicuar padi ndaj ministrit

Murati dhe tre zyrtarëve përgjegjës për këtë pengesë të qëllimshme. Dua t’i falënderoj nga zemra të gjithë punëtorët për durimin, profesionalizmin dhe përkushtimin e tyre, të cilët përkundër sfidave ekonomike dhe presioneve kanë vazhduar të kryejnë punën me dinjitet, duke mos e ndaluar asnjë ditë shërbimin ndaj qytetarëve tanë. Ky është shembulli më i pastër i përgjegjësisë dhe integritetit punëtor. Ju siguroj se jam në krahun tuaj dhe do të vazhdoj me vendosmëri çdo rrugë ligjore e institucionale deri në zhbllokimin e mjeteve të ndërmarrjes deri në shpërblimin e drejtë të çdo punëtori me pagën që e ka fituar me punë. E drejta do të triumfojë, padrejtësia nuk do të tolerohet”, ka shkruar Rama në “Facebook”. Pas kësaj padie, Murati i ka reaguar Ramës, duke thënë se ndërmarrjet komunale janë nën



menaxhimit e komunës dhe qeveria qendrore nuk ka asnjë kompetencë mbi to. “Dështimi total në qeverisje nuk mbulohet me arsyetime të pavërteta, Përparim. Ndërmarrjet publike komunale janë nën menaxhimin e komunës dhe qeveria qendrore s’ka asnjë kompetencë tek to. Shumica e

ndërmarrjeve publike në Komunën e Prishtinës aktualisht gjenden para kolapsit financiar për shkak të keqmenaxhimit e mbipunësimit që ka bërë qeverisja e Përparim Ramës. Kjo është arsyeja kryesore. Gjithçka tjetër është broçkulla. Para kolapsit janë edhe ato ndërmarrje që financohen

kryekëput nga tarifat për shërbimet që ofrojnë, e kjo nuk ka lidhje me buxhetin komunal, por thjesht është keqmenaxhim i komunës. Kjo ka ndikuar që shumë projekte që financohen nga partnerët ndërkombëtarë ose të vonohen apo edhe të rrezikohet në tërësi implementimi i tyre”, ka shkruar Murati në “Facebook”.

Ai ka theksuar se sa i përket buxhetit, tashmë disa herë ka sqaruar për publikun se qeveria qendrore nuk ka bllokuar e as që mund të bllokojë buxhetin e ndonjë komune. “Komuna e Prishtinës e ka bllokuar vetveten duke mos e kaluar projekt-buxhetin brenda afatit ligjor. Këtë e di mirë edhe Përparim Rama, por që i përballur me dështimet gjithandej pas 4 viteve keq-qeverisje, mendon se mund t’i mashtrojë votuesit duke hedhur fajin tjetër kund”, ka shkruar Murati.

KURTISHI: KUJDESI DHE KONTROLLI I HERSHËM, MBROJTJA MË E MIRË KUNDËR KANCERIT TË GJIRIT

PRISHTINË, 27 TETOR - Në podcastin e radhës “Shëndeti në rend të parë”, e mbështetur nga United Hospital, onkologu Ilir Kurtishi ka folur gjerësisht për sfidat, përparimet dhe rëndësinë e vetëdijesimit në luftën kundër kancerit të gjirit.

Kurtishi tha se përvoja e tyre tashmë disave vjeçare ka bërë që sot të jenë më profesionalë, më agjilë dhe më të kujdesshëm në trajtimin adekuat të këtyre sëmundjeve.

Ai nënvizoi se, krahas sëmundjeve të zemrës, kanceri mbetet një nga problematikat më



të mëdha shëndetësore globale, me pasojë të rënda për pacientët

dhe sistemet shëndetësore. Sipas tij, momenti kur një

pacient diagnostikohet me një sëmundje të tillë është shumë i ndjeshëm dhe kërkon mbështetje të plotë - mjekësore, emocionale dhe sociale. “Pacienti duhet të monitorohet dhe të menaxhohet në mënyrën më të mirë të mundshme, duke e përkrahur, duke trajtuar dhe duke e sfiduar sëmundjen”, shtoi ai.

Duke iu referuar muajit tetor, i njohur globalisht si “Muaji Rozë”, Kurtishi kujtoi se fushatat për ndërgjegjësim kanë filluar që nga vitet 1980, falë angazhimit të shoqërisë civile në ShBA dhe Evropë. “Këto fushata kanë pasur

qëllim sensibilizimin, grumbullimin e fondeve për trajtimit dhe, mbi të gjitha, diagnostikimin e hershëm të sëmundjes”, tha ai.

Kurtishi theksoi se diagnostikimi i hershëm është çelësi për suksesin në trajtim. “Në rastet kur sëmundja zbulohet në fazën zero ose të parë, mundësitë e shërimit janë shumë të larta”, u shpreh ai.

Onkologu vlerësoi se Kosova ka bërë përparim të ndjeshëm në trajtimin e pacientëve me kancer gjiri gjatë pesë-gjashtë viteve të fundit.

Arrestohet një prokuror në Prizren nën dyshimet për ryshfet

PRISHTINË, 27 TETOR - Me urdhër të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, hetuesit policorë nga Drejtoria për Hetimin e Krimit të Organizuar dhe Krimeve të

Rënda në Policinë e Kosovës, në bashkëpunim me Kryeprokurorin e Prokurorisë Themelore në Prizren kanë arrestuar B.Sh. nën dyshimin se ka kryer veprën penale

“Marrja e ryshfetit”. I dyshuari B.Sh., prokuror në Prokurorinë Themelore të Prizrenit, është arrestuar në vendin e punës. Prokuroria Speciale së bashku

me Policinë e Kosovës, është duke ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme hetimore, në përputhje me Kodin e Procedurës Penale dhe ligjet në fuqi.



Liburn Aliu emërohet drejtor i Portit të Durrësit

PRISHTINË, 27 TETOR - Ish-ministri i Infrastrukturës në Qeverinë “Kurti 2”, Liburn Aliu, është emëruar drejtor i Portit të Durrësit. Lajmin e kanë bërë me dije të hënën mediet në Shqipëri. Emërimi i Aliut është bërë me

vendim të ministres së Infrastrukturës dhe Energjisë të Shqipërisë. Ai dha dorëheqje më 27 gusht 2025 nga posti i ministrit në Qeverinë e Albin Kurtit, vetëm një ditë pasi Dimal Basha u zgjodh kryetar i Parlamentit të

Kosovës. Në një reagim të bërë gjatë verës, Aliu kishte kontestuar publikisht zgjedhjen e Bashës në krye të Kuvendit, duke e cilësuar atë si “të papranueshme” dhe duke theksuar se pikërisht ky zhvillim ishte arsyeja kryesore e

dorëheqjes së tij. Ende nuk ka një konfirmim zyrtar nga Qeveria shqiptare apo vetë Aliu lidhur me këtë emërim, por burime të afërta me procesin pohojnë se ai ka nisur procedurat e marrjes së detyrës.



KËSHILLI I INVESTITORËVE EVROPIANË: VONESAT NË SEPA I KANË KUSHTUAR KOSOVËS 29 MILIONË EURO NË GJASHTË MUAJ



PRISHTINË, 27 TETOR - Këshilli i Investitorëve Evropianë (EIC) në Kosovë ka bërë thirrje për vazhdimin pa vonesa të procesit të anëtarësimit të Kosovës në Zonën e Vetme të Pagesave në Euro (SEPA), duke e cilësuar këtë si një hap kyç drejt modernizimit të sistemit financiar dhe integritetit më të plotë me tregun evropian. Në komunikatën e publikuar, EIC ka mirëpritur përkushtimin e institucioneve vendore dhe të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), si dhe bashkëpunimin me Komisionin Evropian, duke theksuar se anëtarësimi në SEPA do të sjellë përfitime të drejtpërdrejta për qytetarët dhe bizneset - përfshirë pagesa më të lira, më të sigurta dhe më të

shpejta, si dhe qasje më të mirë në tregje ndërkombëtare. “Sipas vlerësimeve të fundit, vonesat në këtë proces i kanë kushtuar ekonomisë së Kosovës rreth 29 milionë euro vetëm në gjashtëmuorin e parë të vitit, ndërkohë që përfitimet vjetore të mundshme nga përfshirja në SEPA kapin vlerën e 55 milionë eurove”, thuhet në njoftim. Këshilli vlerëson punën teknike dhe rregullative të realizuar nga BQK, në bashkëpunim me Bankën Botërore dhe Komisionin Evropian, duke theksuar se procesi ka avancuar ndjeshëm. EIC apelon që shqyrtimi i ligjeve përkatëse nga Gjykata Kushtetuese të mundësojë vazhdimin e reformave “me kohë

dhe në përputhje me interesin publik”. Në fund, Këshilli thekson se Kosova ka mundësinë reale të mos mbetet prapa vendeve të rajonit dhe të përfitojë plotësisht nga përfshirja në rrjetin unik të pagesave evropiane. “Anëtarësimi në SEPA do të modernizojë infrastrukturën financiare, do të ulë kostot për bizneset dhe qytetarët dhe do ta bëjë ekonominë tonë më tërheqëse për investime të reja,” thuhet ndër të tjera në komunikatë. Këshilli i Investitorëve Evropianë ka rikonfirmuar përkushtimin e tij për të informuar publikun mbi vlerën dhe përfitimet që SEPA sjell për ekonominë dhe qytetarët e Kosovës.

CSL PADIT NË GJYKATËN SUPREME UDHËZIMIN QË PREK 180 MIJË PENSIONISTË

PRISHTINË, 27 TETOR - Qendra për Raste Gjyqësore Strategjike (CSL) ka dorëzuar në Gjykatën Supreme një padi me të cilën kërkon shfuqizimin e disa dispozitave kyçe të Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, që lidhen me procedurat e lajmërimit dhe suspendimit të pensionistëve. Sipas një njoftimi të CSL-së, është kërkuar që Gjykata Supreme të shfuqizojë në tërësi paragrafin 2, 3 dhe 4 të nenit 5 të këtij udhëzimi, me arsyetimin se ato cenojnë drejtpërdrejt të drejtat e afro 180 mijë pensionistëve në Republikën e Kosovës. “Ky cenim ka të bëjë me

ndërprerjen e pagesave për pensionistët që nuk paraqiten me kohë në zyrat rajonale, duke u mohuar më pas edhe të drejtën për kompensim retroaktiv të mjeteve për periudhën kur s’kanë kryer lajmërimin”, thuhet në njoftimin e Qendrës. CSL argumenton se një kufizim i tillë është vendosur me akt nënligjor, pa pasur bazë në ligj, duke cenuar të drejtat dhe interesat e pensionistëve. Përveç kësaj, Qendra ka kontestuar edhe dhjetë dispozita të tjera të të njëjtit udhëzim administrativ, duke e vlerësuar se ato e tejkalojnë hapësirën e autorizimeve të nenit 24 të Ligjit për Skemat Pensionale të

Financuara nga Shteti. Udhëzimi administrativ i vitit 2015 obligon pensionistët të paraqiten çdo gjashtë muaj në zyrat e pensioneve. Nëse nuk lajmërohen, ata fillimisht suspendohen dhe kanë tre muaj afat shtesë për t’u paraqitur në mënyrë që të marrin mjetet e prapambetura. Pas kalimit të këtij afati, kërkesa trajtohet si riaplikim dhe pagesat rifillojnë vetëm nga dita e paraqitjes së re. Aktualisht në Kosovë numërohen mbi 300 mijë pensionistë. Pensioni bazik është 120 euro, ndërsa pensioni kontributpagues arrin deri në 318 euro, varësisht nivelit të arsimimit dhe përvojës kontributdhënëse.



Punonjësit e ZKA-së ndoqën trajnimin për Kodin e Etikës dhe Konfliktin e Interesit




PRISHTINË, 27 TETOR - Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) përfundoi me sukses trajnimin me temën “Kodi i Etikës dhe Konflikti i Interesit”, i cili u zhvillua në katër grupe më 20, 22, 23 dhe 24 tetor 2025. Qëllimi i trajnimit ishte forcimi i integritetit profesional dhe zbatimi i standardeve etike në punën e përditshme në ZKA. Trajnimi u mbajt nga përfaqësuesit e Zyrës Ligjore të

ZKA-së dhe përfaqësuesit e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, të cilët prezantuan ndryshimet e Kodit të Etikës dhe zbatimin e tij në punën e përditshme, rolin dhe përgjegjësitë e Komisionit të Etikës, si dhe për mekanizmat e identifikimit dhe menaxhimit të situatave të mundshme të konfliktit të interesit. Në pjesën e trajnimit për

konfliktin e interesit, u trajtuan obligimet ligjore të zyrtarëve publikë, rastet më të shpeshta që paraqiten në praktikë dhe procedurat e raportimit dhe shmangies së tyre. Përfaqësuesit e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit theksuan rëndësinë e parandalimit të hershëm të situatave që mund të cenojnë paanshmërinë dhe besimin publik.

KUMBARI I REVOLUCIONIT



Tek fillimi i veprës së tij më të famshme, “Manifesti i Partisë Komuniste” në vitin 1848, Karl Marksi shkruante një profeci shqetësuese: “Një hie po bie mbi Evropë. Eshtë spektri i komunizmit”. Në të vërtetë, bëhej fjalë për një ekzagjerim: komunistët në atë kohë ishin pak, kudo që t’i kërkoje dhe nuk ishin ata që udhëhiqnin revolucionet që, atë vit shpërthyen në Francë, Gjermani, në Perandorinë Austro-Hungareze dhe gjetkë. Vetëm në vitin 1917, me rënien e Carit Nikolla II dhe marrjen e pushtetit nga ana e bolshevikëve në Rusi, komunizmi marksist u bë një forcë me të cilën bota duhej të bënte hesapet. Dhe pas revolucionit të Maos në Kinë në vitin 1949, për një farë periudhe më shumë se gjysma e racës njerëzore u udhëhoq nga parimet që të paktën formalisht, buronin prej Marksit. Fytyra e tij krenare mjekërroshe, e ka parë botën nga piktura të pafundme, postera dhe statuja, sikur të dojë të thotë: “Unë kam qenë sebepi i gjithë sa ka ndodhur... ose të paktën unë kam shpjeguar përse ishte historikisht e pashmangshme që të ndodhte. Shkoni dhe ndiqni shembullin tim”. Dhe masa të mëdha ndjekësish e kanë bërë vërtetë. Si dhe përse Marksi u bë një prej mendimtarëve më me ndikim të historisë, ky është një argument që meriton një reflektim. Që në rini, Marksi dallohej për

vendosmërinë, ambicien dhe dëshirën e fortë për ta bërë më të mirë jetën e të gjitha qenieve njerëzore. Në vitin 1869, teksa ndodhej në Hanover, gjatë një loje të shoqërisë viktoriane që quhej “Rrëfime”, ai përshkroi se karakteristika e tij kryesore ishte “përqëndrimi në një qëllim të vetëm”. Studio fillimisht juridik në Bon, më pas filozofi në Berlin, dhe vizioni i tij mbi botën u ndikua thellësisht prej filozofit më të famshëm të kohës, Hegelit. Në vitin 1843 e gjejmë si gazetar radikal në Këln. Në 1844-1845, pjesërisht për shkak të ndikimit të Friedrich Engelsit – një tjetër hegelian, i destinuar të shndërrohej në partnerin intelektual të jetës së tij – aderoi në komunizëm, duke e konsideruar atë si të vetmen zgjidhje të mundshme ndaj të këqiave të proletariatit industrial, që po shfaqej në Britaninë e Madhe dhe në vende të tjera. Pak më vonë, ai dhe Engelsi parashtruan “konceptin materialist të historisë”, që shpjegonte se si kishte lindur kapitalizmi dhe përse sistemi i pronës private dhe përqëndrimit të pasurisë, ishte çelësi për të kuptuar të gjitha shoqëritë njerëzore. Megjithatë, në vitin 1848, jetët e të dyve u tronditën nga vala e revolucioneve që ndau të gjithë kontinentin. Marksi u arrestua (me akuzën se kishte financuar lëvizjen revolucionare) dhe fillimisht mërgoi në Bruksel e Paris,

ndërsa më pas u vendos në Londër, ku mbërriti në qershor 1849 dhe qëndroi deri kur vdiq. Në mërgim, jetoi për shumë vite në lagjen e Sohos në varfëri ekstreme, aq sa shpesh i duhej të mbështetej në ndihmën e mikut Engels, i cili jetonte në fabrikën e pambukut të babait të tij në Manchester. Bashkëshortja e tij tejet besnike, Jenny von Westphalen i “dhuroi” shtatë fëmijë, katër prej të cilëve nuk i mbijetuan fëmijërisë. Mendohet se ka patur edhe një fëmijë të paligjshëm me Helene Demuth: vogëlushi, i quajtur Frederick Demuth, u dha për adoptim dhe ishte Engelsi që pretendoi atësinë, në përpjekje për të shpëtuar reputacionin e Marksit nga shumë kritikë që e sulmonin.

Punëtorët e vdekur nga lodhja

Marksit kaloi pjesën më të madhe të 34 viteve që jetoi në Londër, për të bërë kërkime dhe shkruar tekstin e tij më të rëndësishëm “Kapitali” (në gjermanisht Das Kapital), i shkruaj pothuaj i gjithi nën kupolën e madhe të sallës së leximit të British Museum, i cili kish hapur dyert në vitin 1857. Pjesa më e madhe e përmbajtjes së librit, botuar në vitin 1867, nuk vinte nga përvoja personale e Marksit, por nga “Librat blu”, të cilët përfshinin rezultatet e

inspektimeve në fabrika të ndryshme në Mbretërinë e Bashkuar. Aty përshkruhej përparimi i sektorëve industrialë dhe minierave, tregtisë dhe bujqësisë, shpesh me detaje që vinin në pah gjatësinë e orarit të punës dhe kushtet e tmerrshme të punëtorëve. Marksi përdori gjithashtu gazetën – në një moment të caktuar ai transkriptoi historinë tragjike të Mary Anne Walkley, një banore e Londrës, e cila vdiq nga rraskapitja në moshën 20-vjeçare, pasi kish punuar për tridhjetë orë pa pushim – dhe raportet mjekësore, duke përfshirë një të vitit 1875, sipas të cilit jetëgjatësia mesatare e klasës së mesme e të lartë të Mançesterit ishte tridhjetë e tetë vjet, ndërsa ajo e klasës punëtore ishte shtatëmbëdhjetë. Ai gjithashtu luajti një rol aktiv në komunitetin e punëtorëve emigrantë gjermanë në Londër dhe një rol gjithnjë e më dominues në Shoqatën Ndërkombëtare të Punëtorëve, një institucion i themeluar në vitin 1864, i cili do të numëronte qindra-mijëra aderues në të gjithë Evropën. Kur në fund të Luftës Franko-Prusiane (1870-1871), një revoltë e klasës punëtore i dha jetë Komunës së Parisit, emri i Marksit u shoqërua nga shumë njerëz me këtë të fundit dhe me gjakderdhjen që pasoi, aq shumë sa, për një kohë të shkurtër ai u bë – sipas fjalëve të Engelsit –

“njeriu më i urryer dhe më i neveritur i kësaj epoke”. Megjithë kritikën, Marksit nuk u ndal kurrë së besuari në veten e tij, edhe pse besimi i tij i jashtëzakonshëm kishte një tjetër anë: impulsin për të ditur absolutisht gjithçka për një temë para se të mund të shkruante për të. Vepra e tij zvarritej mes kllapave boshe edhe për vite të tëra, të domosdoshme për të mësuar gjuhë të reja (veçanërisht rusisht) dhe për të mbajtur një sasi të pafund shënimesh. Për më tepër, në moshë të thyer Marksi vuante nga hemorroidet, reumatizma, mëlçia dhe çrregullime të lëkurës e pagjumësi: të gjitha probleme që e mbajtën larg nga tryeza e punës, edhe për periudha të zgjatura. Ishte pa dyshim për këtë arsye që ai nuk e arriti famën botërore sa ishte gjallë: kur vdiq, në vitin 1883, emri i tij nuk ishte veçanërisht i njohur.

Socializmi i shfrenuar

Sidoqoftë, menjëherë pas vdekjes së tij, me Evropën nën kthetrat e krizës ekonomike dhe përhapjes në shkallë të gjerë të socializmit, u formua një kult i vërtetë rreth figurës së tij, dhe brenda njëzet vjetësh vizionin e tij për një jetë të cilën forcat e reja të prodhimit mund të ushqeheshin, të visheshin dhe të kishin një shtëpi dhe një standard jetese më të mirë, nga shu-

mica e klasës punëtore mori një mbështetje të fortë ndërkom-bëtare. Tashmë mendimi i tij ishte vendosur mbi atë të çdo teoricieni tjetër socialist, përfshirë Robert Oëen, Charles Fourier dhe Henri de Saint-Simon. Marksi është varrosur në Londër në varrezat e Highgate, në një varr mbi të cilin, nën një skulpturë të kokës së tij është gdhendur: “Punëtorë të të gjitha vendeve, bashkohuni!” dhe “Filozofët vetëm e kanë interpre-tuar botën në mënyra të ndryshme, por detyra e vërtetë e filozofisë është ta ndryshojë atë”(citim nga një nga veprat e tij të para, “Tezat mbi Feuerbach”). Bëhet fjalë sigurisht për epitafe, që i shkojnë për shtat: Marksi kishte qenë gjithmonë një njeri i veprimit, me objektivin kryesor të shpëtonte proletariatin – domethënë në një shoqëri industriale, pjesën dërrmuese të racës njerëzore – nga lakmia dhe efektet çnjerëzore të kapital-izmit. Ideja themelore, për të cilën Marksi ishte thelluar në 1848, ishte në vetvete mjaft e thjeshtë: kapitalizmi prodhon kriza periodike, në të cilat më të pasurit arrijnë të mbijetojnë dhe madje të pasurohen më tej – duke shitur me koston e prodhimit ose edhe më pak se ajo, nëse është e nevojshme – ndërsa më të varfërit detyrohen të fun-dosen.

Pra, pasuria ka prirjen të përqën-drohet duke ndjekur këtë skemë, ndërkohë që klasa punëtore zbret në nivele mbijetese, apo edhe më poshtë.

Në fund të fundit, sipas mendimit të Marksit, do të vinte domosdoshmërisht një krizë në të cilën klasa punëtore, më në fund e vetëdijshme për alterna-tivën e ofruar nga socializmi dhe e bashkuar nga solidariteti i vetëdijes së klasës (pjesërisht falë edhe natyrës gjithnjë e më sociale dhe bashkëpunuese të prodhimit në shkallë të gjerë në fabrika), do ta përmbyste sis-temin me iniciativën e vet.

Pas rënies së borgjezisë – apo klasës së mesme kapitaliste – klasa punëtore do i jepte formë një shoqërie të re në një fazë tranzicioni, që Marksi ndon-jëherë e quante “diktatura e pro-letariatit”, në të cilën punëtorët e krahut (që më epokën e vonë vik-toriane përbënin 85% të popull-sisë), do të merrnin kontrollin e demokracisë. Prodhimi për fitim do të zëvendësohej nga prodhi-mi për nevojë, organizuar nga forma të planifikimit qendror, dhe të gjithë punëtorët do të marrnin atë që kishin hak, në bazë të parimit: “Secilit sipas aftësisë dhe nevojave!”

Shteti pushon së ekzistuari

Sipas filozofisë marksiste, faza e fundit e shoqërisë komuniste do të shihte rënien përfundimtare të çdo forme të autoritetit shtrengues. Prodhimi dhe arsimi do të integroheshin me njëri-

tjetrin dhe punën e të tjerëve do ta mbikëqyrnin drejtorë të zgjedhur e të zëvendësueshëm, të cilët do të merrnin pagë mesatare. Sapo të shfaroseshin plotësisht klasat sociale, shteti do të pushonte së ekzistuari. Për më tepër, futja e makinerive të reja do të garantonte më shumë kohë të lirë për të gjithë, duke bërë të mundur zhvillimin njerëzor të çdo individi dhe jo vetëm më të pasurve.


Në moshë të thyer, Marksi tërho-qi pohimet e tij më të forta të bëra në rini, mbi idenë e “tjetër-simit” të procesit të prodhimit, duke preferuar të vinte më shumë theksin në rritjen e kohës së lirë dhe mundësinë e arsimimit të cilitdo, por ai kurrë nuk vuri në dyshim as virtytet e as arritshmërinë e qëllimit final: fundit të shfrytëzimit njerëzor.

Kishin kaluar tridhjetë vjet nga vdekja e tij, përpara se teoritë e Marksit të testoheshin në botën e vërtetë, dhe kur kjo ndodhi – në Revolucionin Bolshevik që përfshiu Rusinë në vitin 1917 – ndiki-mi ishte më i madh nga sa men-dohej. Në fund të jetës së tij, Marksi pranoi se revolucioni mund të kishte ndodhur në një vend të pazhvilluar, veçanërisht në Rusi. Ky pohim, megjithatë, përbënte një problem, pasi Marksi kishte zhvilluar teoritë e tij duke marrë si model një vend me standarde jetese shumë më të larta.

Sidoqoftë, ai që e shkëputi real-isht revolucionin bolshevik nga parashikimet Marksiste ishte fakti që drejtohej nga një parti pakice, e cila më pas u ndie e detyruar të mbante frenat e pushtetit. Nuk ka dyshim se Marksi as nuk e kishte parashikuar dhe as shpresuar diktaturën që u shfaq në Rusi me Leninin, Stalinin dhe policinë e fshehtë famëkeqe, aq më pak të paramendonte shpejtësinë me të cilën bolshevizmi do të shtynte zbatimin e ideve të tij, në të gjithë planetin.

Në librin “Imperializmi: forma supreme e kapitalizmit” (1916), Lenini e çoi në një nivel krejt të ri teorinë marksiste të shfrytëzimit, duke lënë të kuptohej se ajo mund të zbatohej në cilëndo zonë të botës, që ishte e pushtu-ar. Pas vitit 1945, duke shfry-tëzuar shansin që ofroi falimen-timi i pothuaj të gjitha fuqive të mëdha evropiane, miliona njerëz filluan të asociojnë emrin e Marksit me vetëvendosjen poli-tike, pavarësinë kombëtare dhe rikthimin e tokës atyre që e kul-tivonin. Marksi u shndërrua në një far të barazisë, dinjitetit dhe mirëqenies potenciale për të gjithë racën njerëzore: objektiva që duheshin arritur jo me konkurrencë dhe antagonizëm, por në një klimë solidariteti, har-monie dhe mbështetjeje reci-proke.

Në fillim, regjimet që u reshtuan nën emrin e Marksit arritën vërtetë shumë në këtë drejtim: në Kinë, miliona qytetarë u çliru-an nga varfëria, varësia nga opiu-



mi dhe dominimi i egër i pronarëve të tokave; Bashkimi Sovjetik arriti të industrializojë vendin brenda vetëm dy gjener-atave (edhe pse me një kosto të tmerrshme), kontribuoi jo pak për mposhtjen e Hitlerit, dhe pavarësisht shkatërrimeve të pësuaara gjatë Luftës së Dytë Botërore, arriti një standart më të lartë jetese, duke kaluar madje për pak kohë edhe SHBA në garën hapësinore, kur Juri Gagarini u bë njeriu i parë që erdhi rrotull në orbitë, në prill të vitit 1961.

Zhgënjim masiv

Gjatë Luftës së Ftohtë, një pjesë e madhe e racës njerëzore u gjet e ndarë, midis tërheqjes nga demokracitë e pasura kapitaliste perëndimore të udhëhequra nga Shtetet e Bashkuara dhe kritikës Marksiste-Leniniste dhe Maoiste, që shpallte se duke pasur parasysh fuqinë e tepruar të klasave dhe korporatave më të pasura, kapitalizmi thjesht nuk mund të jetë demokratik. Njerëzit në mbarë botën duar-trokitën përpjekje të ndryshme për të fituar lirinë nga zinxhirët e sundimit kapitalist ndërkombë-

tar, veçanërisht në Kubë, ku Che Guevara u bë simbol i i epokës së revoltave të studentëve, dhe në Vietnam, ku Shtetet e Bashkuara dukej se u reshtuan në mbështetje të një regjimi të kor-ruptuar dhe reaksionar.

Në vitet gjashtëdhjetë, ndodhi rizbulimi i shkrimeve të rinisë së Marksit dhe në veçanti teoria e “tjetërsimit” në Letrat Pariziane të 1844 ndihmoi në formësimin e të menduarit për “Të Majtën e Re”, dhe për ta bërë vetë Marksin një anti-Stalinist. Por, shtetet komuniste nuk arritën të zbato-jnë një kontroll efektiv të popullit mbi elitat e pushtetit, gjithnjë e më të privileguara dhe të fos-ilizuara, dhe shpesh u reduktuan në persekutimin e çdo forme të disidencës.

Kur përpjekjet për të çliruar veten nga modeli sovjetik në Hungari në 1956 dhe Çekosllova-ki në 1968 ndeshën në një shtyp-je të ashpër, ajo që ndodhi ishte një zhgënjim i vërtetë masiv: komunizmi tani dukej, sipas fjalëve të udhëheqësit studentor francez, Daniel Cohn-Bendit, “Diçka e vjetëruar”.

Në Kinë, Revolucioni Kulturor vuri në shënjestër njerëzit më të arsimuar, duke vrarë mijëra dhe

dëbuar edhe më shumë nga vendi, për plot një dekadë.

Pastaj, me rënien e Bashkimit Sovjetik në 1991, kryesisht e motivuar nga pamundësia e mbajtjes së ritmit në garën e armatimit me Shtetet e Bashkuara, dështimi i modelit Marksist dukej i plotë: në luftën midis ideologjive të botës mod-erne, kishte fituar qartësisht kap-italizmi, dhe Marksit dukej i des-tinuar të bëhej një shënim anomal në katalogun e sipër-marreve njerëzore. Megjithatë, dhjetë vjet pas krizës financiare të vitit 2008, rinovimi i interesit për Marksин është i dukshëm.

Rritja e përqëndrimit të pasurisë nga njëra anë, dhe rritja ekspo-nenciale e varfërisë nga ana tjetër, po i bën sërish të ndjekura analizat e tij, mbi të gjitha për një brez që është rritur mes masave të kursimit dhe që gjendet për-ballë një perspektivë jo dhe aq rozë, se sa ajo e brezit të mëparshëm.

Ky artikull i Gregory Claeys, Docent i Historisë në Royal Holloëay është marrë nga History today dhe sjellë në shqip nga bota.al



SAINT-GOBAIN
SEKURIT
Enveri
PILKINGTON

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com





QENDRA SPORTIVE

'BUJOËSIA'

TEL: 045/82 82 82

Altin Aliu, “Ylli i Javës” në Superligë

PRISHTINË, 27 TETOR - Federata e Futbollit e Kosovës (FKK), në bashkëpunim me sponsorin zyrtar të Superligës, Albi Mall, ka vazhduar ndarjen e çmimit tradicional “Ylli i Javës”, i cili i dedikohet futbollistit më të dalluar të javës në Superligën e futbollit kosovar. Për javën e dhjetë të këtij edicioni, ky

çmim i është ndarë futbollistit të FC Malisheva, Altin Aliut, i cili ka shënuar të dy golat në ndeshjen kundër FC Prishtina e Re, e cila ka përfunduar me rezultat 2:0, duke arkëtuar tri pikë të rëndësishme për skuadrën e tij. Vlerësimi është bërë nga Komisioni i Veteranëve të Futbollit në përbërje të Afrim

Visoka, Agim Xhakolli dhe Fisnik Ademi. Pasi ka marrë këtë çmim, Aliu është shprehur i lumtur që është vlerësuar si lojtari më i mirë i javës. “E kemi përgatitur këtë ndeshje në mënyrë shumë të mirë, duke e analizuar në detaje kundërshtarin. Malisheva është duke punuar në

këndelljen e ekipit dhe shpresojmë që do të jemi në objektivat tona, si zakonisht. Objektivi i klubit tonë është dalja në Evropë. Kemi pasur një lodhje dhe jemi duke e rimarrë formën tonë. Falënderoj bashkëlojtarët dhe stafin për ndihmën e dhënë gjatë lojës. Është ndjenjë e mirë të shpallesh



lojtari më i mirë i javës dhe shpresoj që të shpërblehem më shpesh me këtë çmim”, ka thënë Aliu për faqen zyrtare të FFK-së.

DAKU: FITORJA NDAJ SERBISË MË E MADHJA NË KARRIERË, FANTASTIKE QË SHQIPËRIA DHE KOSOVA TË JENË NË BOTËROR



TIRANË, 27 TETOR - Shqipëria do të luajë shanset e saj në nëntor, ku do të përballlet fillimisht ndaj Andorrës në transfertë e më pas do të presë në Tiranë skuadrën e Anglisë, për të mbyllur kualifikueset e Botërorit. Për “Panorama Sport”, ka folur sulmuesi i kuqezinjve, Mirlind Daku, i cili është shprehur se Shqipëria sheh veç nga ndeshja e radhës, duke e cilësuar njëkohësisht fitoren në Serbi si më të rëndësishmen në karrierë.

sheh ecurinë e Kombëtares në këtë periudhë?

Daku: Mendoj se vetë rezultatet tregojnë qartë punën që po bëjmë. Kemi kaluar një periudhë të mirë, me përkushtim dhe sakrifica, dhe kjo po reflektohet në fushë. Shpresoj që të vazhdojmë në të njëjtin ritëm edhe në dy ndeshjet e fundit, që ta mbyllim këtë cikël sa më bukur dhe t'i bëjmë të gjithë shqiptarët krenarë.

Si e përjetove personalisht fitoren kundër Serbisë?

Daku: Për mua është fitorja më e madhe në karrierën time. Duke marrë parasysh gjithçka, rrethanat, historinë e gjithçka tjetër, e konsideroj si fitoren më të bukur dhe të veçantë.

Kosova ecën në një rrugë të ngjashme me Shqipërinë. Mendon se është gati për në “play-off”?

Daku: Po, mendoj se Kosova e meriton plotësisht të jetë në garë për “play-off”. Uroj me gjithë zemër që ta realizojë këtë ëndërr, sepse do të ishte një arritje historike. Do të ishte fantastike që si Shqipëria ashtu edhe Kosova të ishin në një Kampionat Botëror.

PRISHTINA VAZHDON SERINË E FITOREVE DHE FORCON POZITËN E PARË

PRISHTINË, 27 TETOR - Prishtina ka vazhduar ecurinë mbresëlënëse në Albi Mall Superligën e Kosovës, duke regjistruar fitoren e gjashtë radhazi. Kryeqytetasit kanë triumfuar me rezultat 2:0 ndaj Dukagjinit, në ndeshjen e javës së 10-të që është zhvilluar në stadiumin “Fadil Vokrri”. Me këtë fitore, Prishtina e ka përforcuar pozitën e parë në tabelë me 25 pikë, gjashtë më shumë se Ballkani që ndodhet në vendin e dytë. Fitore të

rëndësishme ka shënuar edhe Malisheva e cila ka mposhtur Prishtinën e Re me rezultat 2:0, ndërsa ndeshja në mes të Ballkanit dhe Gjilanit është mbyllur me barazim dramatik 1:1. Xhiroja e dhjetë e AlbiMall Superligës së Kosovës është mbyllur me ndeshjet e zhvilluara në Gjilan dhe Podujevë. Kampionia në fuqi, Drita, ka vazhduar serinë pozitive në kampionat, duke e mposhtur Ferizajn me rezultat 3:1, kurse Llapi ka arritur fitore

dramatike ndaj Drenicës, me rezultat 4:3, në stadiumin “Zahir Pajaziti” në Podujevë.

XHIROJA E 10-të, RENDITJA TABELARE:	
Prishtina	25
Ballkani	19
Drita	17
Dukagjini	14
Llapi	13
Malisheva	13
Drenica	11
Gjilani	11
Ferizaj	10
Prishtina e Re	7



Juventus shkarkon trajnerin Tudor

TORINO, 27 TETOR - Igor Tudor nuk është më trajner i Juventusit. Me anë të një deklarate për mediet, “Zonja e Vjetër” ka njoftuar për shkarkimin e teknikut kroat. Së bashku me Tudorin do të largohet edhe pjesa tjetër e stafit teknik. Përcaktues në këtë vendim të

fortë ishte ecuria shumë e dobët e “Zonjës së Vjetër” këtë periudhë, ku përballë Lazios ka pësuar humbjen e tretë radhazi, ndërsa kanë tetë ndeshje që nuk fitojnë. Për momentin, deri në gjetjen e një trajneri të ri, drejtimin e Juves për takimin kundër Udineses do

ta marrë Massimo Brambilla, trajneri i Next Gen, një zgjedhje kjo brenda shtëpisë për t'i dhënë më shumë kohë drejtuesve të klubit për të gjetur profilin e duhur. Emri i parë në listën e dëshirave është Luciano Spalletti, ky nuk është një sekret, por ideja

që ish trajneri i Italisë të pasojë Tudor në Torino po përforcohet gjithnjë e më shumë. Një tjetër ish trajner i Italisë që po lakohet këtë periudhë është edhe Roberto Mancini. Ndërkohë jashtë Italisë, këtë periudhë po lakohen emra si Edin Terzic, Xavi dhe Southgate.



Duke u bazuar në nenin 7 të Udhëzimin Administrativ (MMPHI) Nr.01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ MMPHI – Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në bashkëpunim me operatorin "Fidani – Beton” Sh.p.k. kërkesa për t’u pajisur me Leje Mjedisore, për veprimtarinë: Bazë e betonit, Baballoq, Deçan, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për kërkesën për t’u pajisur me Leje Mjedisore

Njoftohet publiku i interesuar se me datë: 21.11.2025, në ora : 10;45, në hapësirat e Administrative te kompanisë Fidani Beton Shpk me adresë Rr Arben Qerimaj Nr 180 Baballoq-Deçan , do të organizohet debat publik nga operatori "Fidani – Beton” Sh.p.k. kërkesa për t’u pajisur me Leje Mjedisore me Nr.Prot.25/7233/MMPHI/608/DMM, për veprimtarinë: Bazë e betonit, Baballoq, Deçan, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

Linku : <https://us05web.zoom.us/j/86993072373?pwd=OO1NRDl9EnlWjFpvhvxaIfXJFaB9S2.1>

Në linkun e mëposhtëm, mund të gjeni aplikacionin e publikuar në ueb faqe të MMPHI-së, për komente të publikut:

<https://mmphi.rks-gov.net/Document?search=fidani>

Pjesëmarrja e publikut është e mirëseardhur dhe e rëndësishme për procesin.

Me respekt,
"Fidani – Beton” Sh.p.k.
Datë : 24.10.2025

Duke u bazuar në nenin 7 të Udhëzimin Administrativ (MMPHI) Nr.01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ MMPHI – Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në bashkëpunim me operatorin ”Benita Company” Sh.p.k. Gremnik, Klinë, kërkesa për t’u pajisur me Leje Mjedisore, për veprimtarinë: Thërrmim dhe seperim i gurit gëlqeror në Vërbnicë, Mitrovicë, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për kërkesën për t’u pajisur me Leje Mjedisore

Njoftohet publiku i interesuar se me datë: 20.11.2025, në ora: 09:30, në hapësirat e E OBJEKTIT NE ZYRE TE KOMPANIS BENITA COMPANY SH.P.K. NE FSHATIN VËRBNICË – MITROVICË , do të organizohet debat publik nga operatori "Benita Company” Sh.p.k. kërkesa për t’u pajisur me Leje Mjedisore me Nr.Prot.25/5425/MMPHI/417/DMM, për veprimtarinë: Thërrmim dhe seperim i gurit gëlqeror në Vërbnicë, Mitrovicë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM <https://us05web.zoom.us/j/7603529188?pwd=apt7XLXxExYbabh4brs90FteNKvei9.1&omn=87356786797>

Në linkun e mëposhtëm, mund të gjeni aplikacionin e publikuar në ueb faqe të MMPHI-së, për komente të publikut:

<https://mmphi.rks-gov.net/Document?search=benita>

Pjesëmarrja e publikut është e mirëseardhur dhe e rëndësishme për procesin.

Me respekt,
"Benita Company” Sh.p.k.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Refki Demiri shpall te pavlefshme diplomën QK “11 Marsi “ Prizren.

- Shkelqim Krasniqi shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën QK “11 Marsi” Prizren.

- Muharrem Shala shpall të pavlefshme diplomën si dhe dëftesat e shkollës fillore “Mustafa Bakija”.

- Albatros Manxhuka shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e shkollës së mesme “Gjon Nikoll Kazazi”.

- Shqiprim Morina shpall të pavlefshme diplomën dhe dëftesat e shkollës së mesme “12 Maji”.

- “Fire Protection Agency Rifiel Action” L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 330530669.

- Bekim Selimaj shpall të pavlefshme diplomën e Kolegjit Biznesi.

- Meritë Bytyqi shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë “Luciano Motroni” Prizren.

- Blend Mustafaj nga Deçani, shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 si dhe diplomën e sh.m. mjekësisë “Htsni Zajmi”.
- Simunida Maksuti shpall te pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12.13. si dhe Diplomën e sh.m. Prof. “Gjon Nikolle Kazazi” Teknologji Informative Gjakove.

- NNSH “Meridian”, shpall të pavlefshme numrin UNIK të biznesit: 810227406, të lëshuar nga ARBK.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)



According to Article 40 of Law No. 04/L-042 on Public Procurement of the Republic of Kosovo, amended and supplemented with the law No. 04/L-237, law No. 05/L-068 and law No.05/L-092

Date of the preparation of the Notice: 27/10/2025

Procurement No	Mentoring- AGRO	001	2025	221
----------------	--------------------	-----	------	-----

This notice has been prepared in the LANGUAGES:

English x

SECTION I: CONTRACTING AUTHORITY

I.1) NAME AND ADDRESS OF THE CONTRACTING AUTHORITY (CA)

Official name: Kosovo Humanitarian Charitable Society “Mother Teresa”		
Postal address: str. MujëKrasniqin.n.Ulpiana U1/1		
Town: <i>Prishtina</i>	Postal code:10000	Country:Kosovo
Contact point(s): Zef Shala		Telephone:038-542-865
Email:zefshala@hotmail.com		Fax:038-542-869
Internet address (<i>if applicable</i>):		www.matherteresasociety

SECTION II: OBJECT OF THE CONTRACT

II.1) DESCRIPTION

II.1.1) Contract title attributed by the contracting authority: Provision of Mentoring and Coaching Services for 100 Beneficiaries		
II.1.2) Type of contract and location of works, place of delivery or of performance <i>(Choose one category only - works, supplies or services - which corresponds to the main part of the specific object of your contract)</i>		
		X Services
II.1.5) Short description of the object of the contract Provision of Mentoring and Coaching Services for 100 Beneficiaries		
II.1.6) Common Procurement Vocabulary classification (CPV) 93.000.000.-8		
II.1.7) Variants are accepted		No x

II.1.8) Division into lots	NO	x
Provision of Mentoring and Coaching Services for 100 Beneficiaries		
II.1.11) Estimated contract value: Approximately 130,000.00		

II.2) QUANTITY OR SCOPE OF THE CONTRACT

II.3) DURATION OF THE CONTRACT OR TIME LIMITS FOR COMPLETION

Duration in months **6 month** (from the contract signature)
or
 Starting **01/12/2025**
 Completion **30/05/2026**

SECTION III: LEGAL, ECONOMIC, FINANCIAL AND TECHNICAL INFORMATION

III.1) CONDITIONS RELATING TO THE CONTRACT

III.1.1) Performance security required	NO
III.1.2) Legal form to be taken by grouping of economic operators to whom the contract is to be awarded (if applicable)	
III.1.3) Other particular conditions to which performance of the contract is subject	No ☒

III.2) CONDITIONS FOR PARTICIPATION

III.2.1) Eligibility Requirements: 1. Certificate of Business Registration 2. Fiscal Number Registration 3. VAT-Certificate if applicable <i>Documentary evidence required</i> Copy of documentary	III.2.2) Professional Suitability: 1.Business Registration Certificate 2.List of proposed experts and administrative staff and their cv-s 3 References of previous experience in similar projects <i>Documentary evidence required:</i> Copy of prove documents
III.2.3) Economic and financial capacity 1. Tax Verification from Tax Administration of Kosovo (for Winner Company only) 2. Certificate from Justice that's Company and person representative is not on any justice process (for Winner Company only) 3. Company profile <i>Documentary evidence required:</i> Copy of documentary	III.2.4) Technical and professional capacity 1.Business Registration Certificate 2.List of proposed experts and administrative staff and their cv-s 3 References of previous experience in similar projects

Documentary evidence required:
Copy of prove documents

III.3) CONDITIONS SPECIFIC TO SERVICE CONTRACTS

III.3.1) Execution of services is reserved to a particular profession	No	☒
III.3.2) Legal persons should indicate the names and professional qualifications of the staff responsible for the execution of the service	Yes	☒

SECTION IV: PROCEDURE

IV.1) TYPE OF PROCEDURE

IV.1.1) Type of Procedure	
Open	

IV.2) AWARD CRITERIA

Lowest price

IV.3) ADMINISTRATIVE INFORMATION

IV.3.1) Previous publications concerning the same contract	No	☒
IV.3.2) Conditions for obtaining <i>tender dossier</i> Time limit for receipt of requests for <i>tender dossier</i> : date 07/11/2025		
Payable documents	No	☒
IV.3.3) Time limit for receipt of <i>tenders</i> <i>Date 13/01/2023 time 14:00 place Prishtina</i>		
IV.3.4) Time limits is shortened for submission of <i>tenders</i>	☒	no
IV.3.5) Is tender security needed:	No	☒
IV.3.6) Tender validity period: date: 21/11/2025 days 30 or months 1		
IV.3.7) Tender opening meeting: <i>Date 21/11/2025 time 14:30 place Prishtina</i>		

SECTION V: COMPLEMENTARY INFORMATION

V.1) COMPLAINTS

Any interested party may file a complaint with the Contracting Authority according to article 108/A of the Law No. No. 04/L-042 on Public Procurement of the Republic of Kosovo, amended and supplemented with the law No. 04/L-237, law No. 05/L-068 and law No.05/L-092,at the address specified in Section I of this Contract notice.

V.2) ADDITIONAL INFORMATION

Note: Economic operators will be entitled to submit a tender, request to participate and other documents required or permitted to be filed during the conduct of a procurement activity in Albanian, Serbian or English.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë






www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992





ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1905

Columbus, Georgia, USA
Since 1905
0.5L